

HEKURAN HASANAJ

**“ANTHOLOGJI SHQIPE E KËSIKOHËSHME”, 1937, LLAZAR GUSHO
SPROVË PËR RINDËRTIMIN PRAPAVAJTËS TË KRITEREVE
TË ZBATUARA**

- Një antologji me kritere mirëfilli estetike.
- Një antologji e pavarur prej politikave zyrtare?

Për të bërë një sprovë mbi rindërtimin prapavajtës të kritereve që zbatoi Lasgush Poradeci në antologjinë e tij, së pari po shqyrtojmë kriteret bazë që i nevojiten një antologjie për të qenë e tillë. Vetë fjala *antologji* vjen nga greqishtja e vjetër, pjesët përbërëse, të së cilës sqarojnë thelbin e saj: *lule+mbledh* apo *zgjedh*. Kjo në rastin tonë përkthehet: një buqetë autorësh të përzgjedhur sipas kritereve të mirëcaktuara që i bën të detyrueshme titulli i antologjisë, i cili si rregull projekton rrugën që do të ndiqet. Ky titull është ai që hedh sinoret për kohën që do të përfshihet në antologji, për vendin, shtrirjen gjeografike me gjithë përmasat që do të paraqiten aty, rrymën letrare që përshkon dhe mbrun veprat, estetikën që thur dhe lustron veprat, politikën dhe kushtet social-kulturore që nuk janë vetëm panoramike, por që bëhen pjesë e veprave, arsyeve dhe mosarsyeve që ato ekzistojnë, dhe, së fundi edhe e shijes personale të përzgjedhësit, e cila pavarësisht seriozitetit e profesionalitetit nuk mund të mënjanohet plotësisht. Deri në momentin që Dr. Gushe paraqet dorëshkrimin për botim në *Institutin e Studimeve Shqiptare*, mendimi kritik shqiptar kishte bërë përpjekje të konsiderueshme, por jo të një niveli të kënaqshëm. Arsyet pse dilet në këtë përfundim janë të ndryshme. Fillimet e sprovave vijnë në gjuhë të huaj, janë sporadike e përveç kësaj, nuk janë për një jehonë që shtrihet gjerë, sepse praktikisht ato nuk vijnë në shqip dhe në Shqipëri dhe ngelen si materiale në qarqe të caktuara, në rrethe të ngushta intelektualësh e që i mbeteshin në duar një *“publiciteti gojor”*. Kjo, pasi mjetet e komunikimit fizik në ato kohë ishin të një niveli që linte shumë për të dëshiruar. Në shumicën e rasteve mbeteshin tentativa personale pa platforma të qarta dhe me teprica entuziaste të të dy kaheve: negativ dhe pozitiv, kur dihet që kritika ka për detyrë bazë konstatimin dhe nuk pranon

shpërqendrimin emocional të kritikut. Shumë vepra ngelën si shenja të diletantizmit pasi kritika e vërtetë mungonte dhe jemi në rrjedhat e saj fillestare. Të gjitha këto mbeten në kuadrin e eksperimenteve që gjithsesi duhen vlerësuar, në mos si prova shkencore, si prova të guximit për të nisur një faqe të re për letrat shqipe dhe si prova parashkencore. Kritika e vërtetë jep shenjat e saj në kohën kur letërsia mori formë si e tillë. Prandaj, në kohën kur mendimet dhe sprovat e para kritike filluan të shfaqeshin, ishin të justifikuar në një fare mase për nivelin e tyre, pasi dhe vetë letërsia, baza reale mbi të cilën ngrihet mendimi dhe gjykimi kritik, ishte në nivele modeste. Citoj:

V. Dorsa: *Sugli albanesi- ricerche e pensieri*, 1847; J. G. Hahn: *Albanesische studien*, 1854; De Rada: *Principi di estetica*, 1861; G. Mayer: *Mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe*, 1883; G. Mayer: *La nuova Antologia*, 1885; De Rada: *Antologia Albanese*, 1896; M. Lambertz: *Zwischen Drin und Voiussa*, 1922; G. Petrotta: *Poplo, lingua e letteratura Albanese*, 1932; E. Çabej: *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, 1936.

Fill pas kësaj tradite, Poradeci mori përsipër detyrën e vështirë të prezantimit të letërsisë moderne shqipe të kësikohshme (bashkëkohore) në një vepër antologjike. Në vitet '30 ishte mbyllur përfundimisht letërsia e periudhës së Rilindjes Kombëtare. Në këtë kohë letërsia u zhvillua si polifoni, pra heterogjeniteti i kësaj letërsie, pasoi shthurjen e romantizmit¹. Me njohjen ndërkombëtare të pavarësisë, krijimin e shtetit shqiptar, aspiratat popullore edhe në drejtimin shpirtëror po kërkonin rrugë të reja, por etnocentrizmi mbeti si një përbërëse e fortë e letërsisë paralel së cilës qëndronte trendi properëndimor. Në hyrje të "*Anthologjisë ...*" Llazar Gushe shprehet: *Literatura shqipe, popullore ose kulte prezanton njëkohësisht me përgjasjen me literaturat e tjera të Ballkanit një note etnike të saj të veçantë*. Ndërsa E. Çabej thotë duke përgjithësuar fenomene të letërsisë shqipe e të letërsive të Ballkanit: *Por, ndofta me kohë do të ndryshojë faqja kulturore – politike e popujve ballkanikë; literaturat e tyre mund të marrin një here rrugë të re, duke pasur për qëllim më shumë krijimin e një arti të thjeshtë e të vërtetë*. E gjithë kjo gjendje kulturore, politike, sociale, letraro-artistike e fillimit të shekullit XX ia vështirësonte misionin studiuesit Llazar Gushe. Të mos lëmë pa përfshirë

¹ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Studime, Tiranë, 2010, f. 360.

këtu edhe eksperiencat pararendëse të mendimit kritik që mbeteshin më shumë në kuadrin e një sprove.

Shkrimtarët e kësaj periudhe vinin me bagazhin e edukimeve të ndryshme (perëndimore dhe lindore), ishin mbartës të ideve iluministe që rrezatoi Revolucioni Iluminist Francez, por mbartnin gjithashtu edhe tranzicionin politiko-social të vendit. Gjithë kjo polifoni zërash e ndjesish brenda secilit, domosdoshmërisht do të lindte një letërsi polifonike, një element ky që modernia e përmban. Zbatimi i kriterit historik nuk përbënte më problem në kohën kur e shkroi Poradeci veprën, pasi Rilindja e kishte mbyllur ciklin e saj, ndërsa romantizmi vazhdonte të frymonte në veprat e shkrimtarëve të këtij brezi. Gjithsesi, dalja në dritë e një përmbajtjeje të re të mbrujtur me një formë të re, përkoi në dukje (nga ana shifrore) me dy shekuj, pasi datëlindjet e të gjithë zërave të përfshirë rezultojnë në fund të shekullit XIX. Pavarësisht kësaj, pjekuria e tyre artistike dhe madje në disa raste kulmimi i saj janë të fillimeve të shekullit XX. Prerje dhe ndarje strikte të kohës nuk mundemi as t'i imagjinojmë kur bëhet fjalë për letërsi, prandaj fenomeni “*Kristoforidhi*” (me cikël të mbyllur jete e krijimtarië brenda shek. XIX) nuk përbën material për diskutim thelbësor për të mos i dhënë Llazar Gushos pikët e mundshme për zbatimin rigoroz të kriterit historicist në veprën e tij antologjike. Në lidhje me estetikën që i bashkon këta autorë në këtë buqetë, gjykojmë se është ajo e një forme të re letrare, e një strukture të re dhe e një ndjeshmërie të re të konceptimit të botës dhe individit: gjithçka më e re dhe më e thellë se letrat pararendëse. Poradeci vetë konstaton se *literatura shqipe mban përgjithërisht karakterin e vendit “ku pat lindur”, gjë e cila është një shënjë e mirëardhur e zhvillimit të arthmë të frymës së saj në kuadrin e racës.*²

Një antologji me kriterë mirëfilli estetike

Për kriteret që ka ndjekur dhe zbatuar në përzgjedhjen e zërave të veprës së tij ai vijon me shprehjen: ... *sikundër ka rezultuar kronologjikisht dhe sipas krahinave të ndryshme ku ka marrë qenie, ajo mund të ndahet lehtë në etapa kohore dhe përkufizime krahinore*. Duket që Poradeci ka njohje të mira për letrat shqipe, për kronologjinë dhe shpërndarjen e tyre në hapësirën gjeografike. Vërejmë që estetika e zërave të antologjisë vjen e prirë nga koha reale dhe kushtet në të cilat lindi kjo letërsi. Një sy skeptik do të hidhte hije dyshimi mbi disa zëra që edhe sot e kësaj dite ose nuk janë rehabilituar plotësisht, pasi u bënë viktima të sistemit politik (që

² L. Poradeci, *Vepra II*, Tiranë, 2010, f. 326 .

rrethoi me tela me gjemba edhe letërsinë) ose kanë mbetur në hije për arsye të ndryshme (mungesë vëmendjeje nga syri kritik, promovimi pararendës që Poradeci bëri për ta mbeti i harruar në AQSH, ose (po vihem në rolin e skeptikëve) Poradeci i promovoi disa zëra me vepra inedite, të cilat mbetën ashtu edhe sot e ndoshta që një promovim entuziast më tepër se masa e lejuar për një mendimtar arti. Le të qetësohemi: t'i davarisim këto hije skeptike dhe të nxjerrim në pah deri në ç'masë syri kritik i Llazar Gushos shmang shijet personale. Shkrimtarët që sistemi komunist përjashtoi me përdhunë si Zef Skiroi, Gjergj Fishta, Vinçenc Prennushi, Ernest Koliqi, Lumo Skëndo në ditët e sotme u rehabilituan dhe vepra e emri i tyre zuri vendin e merituar në letrat shqipe. Pikëpyetjet varen ende mbi emrat e shkrimtarëve: *Loni Llogori, Hamid Gjylbegaj, Mihal Sherko, Stefan Shundi, Anton Logoreci, Hilmi Leka*.

Me biografitë e shkurtra shkrimtarët e mësipërm vijnë të prezantuar për herë të parë nga Llazar Gusho si zëra jo vetëm premtues, por edhe si mbartës të estetikës moderne, që ishte indi lidhës i letërsisë së viteve të para të shekullit XX e që kulmoi pikërisht në vitet '30. Dalim në konstatimin se kriteri estetik është një fill, të cilin Dr. Gusho nuk e mënjanon. Është pranuar tashmë se shija personale e mbledhësit të antologjisë nuk mund të shpërfilllet, sepse është ajo nxitja kryesore që e bën një studiues të ndërmarrë një punë e një mision të tillë dhe që herë-herë ngre krye dashur pa dashur nëpër mendimet dhe sfidat kritike. Kështu që afeksioni personal i tij për *H. Lekën, A. Logorecin, S. Shundin, M. Sherkon, L. Logorin, H. Gjylbegajn* etj. nuk e zbeh punën e tij prej studiuesi. Lasgushi vetë, në këtë kohë, e kishte kulmuar dhe përfunduar krijimtarinë e tij. Ai ishte poeti më i formuar i atij brezi dhe kjo nuk ishte tepërcë të deklamohej nga ata që e njihnin letërsinë, e pikërisht kjo lloj qasjeje e të kuptuarit dhe vlerësuarit e këtyre zërave të rinj ndaj Lasgushit tregonte indirekt që ata ishin të formuar artistikisht, estetikisht mbi frymën moderne të letrave shqipe në fillimet e shekullit XX. Kur vlera e Poradecit dihej botërisht, përse do ta joshte atë komplimentimi nga disa zëra të rinj madje do ta joshte aq shumë sa që ndoshta në mënyrë të pa merituar do t'i vinte si zëra përfaqësues të letrave moderne në veprën e tij? Duket fëmijore t'i besosh kësaj. Më mirë duhet t'i hedhim sytë në filtrat e kohës reale, të kushteve të rënda politike që pasuan, të problemeve sociale dhe të ideologjive që mbushën me dhunë mendjet e shqiptarëve dhe që pushtuan mekanikisht letërsinë shqipe të mëvonshme. Të gjitha këto nuk lejuan që zërat, të cilët filluan promovimin në veprën e Llazar Gushos, të bëheshin këngëtarët e vërtetë të letërsisë shqiptare bashkëkohore që vijoi. Jeta e disa

prej tyre u pre mizorisht në mes dhe mbeti që kjo antologji inedite e mbushur me veprat e tyre, në një pjesë të madhe, edhe ato inedite, të tingëllojë si kënga e mjellmës. Një pjesë të shkrimtarëve i mbuloi pluhuri i indiferencës bashkë me Lasgushin vetë, veprën e tij poetike e si rrjedhojë edhe me sfidën e tij antologjike. Pjesa tjetër u vranë apo mbetën në arrati dhe iu desh të duronin përbaltjen e moralit, atdhetarizmit, emrit, jetës, veprës së tyre. Ata që u vranë mizorisht nuk mundën më që me talentin e tyre të bënin rrugën premtuese që patën nisur, për më tepër veprat e tyre vazhduan të zverdheshin në sirtarët e harresës e të mos botoheshin. Vepra e Llazar Gushos *Anthologji shqipe e kësikohëshme* duhet vlerësuar si e tillë. Ajo zbatoi kriteret që kërkon një antologji: kriterin historik, estetik, shpërndarjen gjeografike, pozicionimin politiko-social, shijen e lehtë, por të pashmangshme personale. Dhe të mos harrojmë: ai nuk pati një pararendëse të mirëfilltë antologjike, por i mbështetur në sfidat antologjike të kritikëve të letrave shqipe (si De Rada, Mayer, Petrotta, Lambertz, Çabej) hodhi bazat për një antologji shqipe të mirëfilltë të pozicionuar mirë në kohë (shekulli XX), në estetikë (formë e re, moderne, botë e re, individit në thellësi si i tillë pa shmangur kornizën etnike), në hapësirë (kujdeset që të përfaqësohen të gjitha krahinat e Shqipërisë), në lloje (poezi, prozë, dramë), në shije personale (është kjo një nuancë që mban erë lasgushiane jo vetëm në zgjedhje, por edhe në stil të shkruarit).

Një antologji e pavarur prej politikave zyrtare?

Ideale është që arti të jetë art dhe shkenca të jetë shkencë, të mos ketë asnjë varësi jashtë vetes, përveç fijeve të brendshme që e mbajnë në këmbë. Në një antologji përzgjedhja, si rregull, duhet të mos ndikohet nga elementet jashtëletrare. Por, a ndodh gjithmonë kështu? Politike nuk quhet vetëm politika në kuptimin e saj më të parë, por çdo gjë e qëllimtare, çdo angazhim që ndërfitet si trup i huaj, si ndërkallje që lëshon metastaza, pushtimi i të cilave çon në humbjen e vlerave të antologjisë si të tillë dhe në humbjen e aftësisë për t'u rezistuar kohërave. Lasgushi merr përsipër të paraqesë antologjinë për letërsinë moderne bashkëkohore të shekullit XX (deri në vitin 1937). E bën këtë ndërmarrje, sepse letërsia shqipe moderne kishte krijuar tashmë fytyrën e saj dhe ishte e gatshme për një antologji. Shkëputja nga shekulli i mëparshëm kishte ardhur edhe me një frymë të re në koncepte dhe në art, të nxitura këto edhe nga gjendja e re politike. Në vitin 1912 ishte shpallur Pavarësia e Shqipërisë. Viti i mbrapshtë 1913, gjeneroi e degjeneroi situata të pasigurta politike-social-ekonomike-kulturore dhe solli edhe hutimin e një populli që nuk di të menaxhojë lirinë

e shumëpritur. Dëshira për liri ishte pjekur me kohë, por fuqia konkrete udhëheqëse intelektuale ishte e papjekur dhe e pabashkuar për të vepruar.

Në të tillë kontekst, përveç atij të sotmit, duhet të shqyrtojmë mungesën në antologjinë e Dr. Gushos të tre zërave të rëndësishëm të letrave shqipe: Noli, Konica, Migjeni.

Fan Noli

Tërhiqet nga politika dhe e lë Shqipërinë me një armiqtësi të përjetshme mes tij dhe A. Zogut. Dështoi si politikan, por si personalitet publik nuk ishte kjo përballja dhe prezantimi i parë me shqiptarët. Bota intelektuale dhe qarqet letrare e patën njohur më parë atë si një përkthyes elegant, që solli në shqip veprat e fuqishme të klasikëve botërorë, si një përkthyes që bëri të flasë shqip me shqiptarin Shekspirin, Servantesin, Ibsenin, Khajamin, Ibanjezin, Edgar Alan Poenë etj.

Një vit para “*Anthologjisë...*”, pra në vitin 1936 tek vepra e tij “*Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*” Eqrem Çabej sjell Fan Nolin si një zë në veprën e tij. *Kjo vepër është një studim historiko-letrar dhe prezanton një rrjetë të vlerave letrare shqipe në rrjedhë kronologjike.*³ *Veprat që e kanë vënë Nolin në rend të parë të literaturës shqipe moderne janë përkthimet e veprave të literaturës së përbotshme ... Talenti lirik i Nolit çfaqet përveç disa vjershash rasti ...*⁴.

Dhe dihet që, kronologjikisht, afirmimi i Nolit si poet vjen vite më vonë, në 1948, gati pas një dekade me “Albumin”. Për veprën e tij “*Elemente ...*” Çabej thotë: “*Në qoftë se ky libër ka një anë shkencore, kjo do të ishte jo zgjidhje problemesh, po hedhje problemesh në lëmë të bisedimit. Pra, nëse libri do të mundij të kontribuojë pak në zgjerimin e interesit për gjuhën dhe për literaturën t’one artistike dhe popullore, dëshira e autorit do të jetë plotësisht e përmbushur*”. Çabej vlerëson përmes zërit të Nolit në veprën e tij potencialin e gjuhës shqipe (libri i tij që në titull tregon interesim për elementet e gjuhësisë) për t’u përballur me gjuhët e mëdha e të kultivuara si anglishtja e spanjishtja, por edhe personalitetin dhe talentin e një përkthyesi, shqipëruesi e kritiku si Fan Noli. Talentin e tij lirik ai e cek duke e përmendur “*disa vjersha rasti ...*”.

Në vitin 1937, në “*Shënime rreth literaturës shqipe*”, Fan Noli vjen i prezantuar me këto rreshta: “*Kollonia e Amerikës lansoj Fan Nolin (lindur*

³ S. Hamiti, *Poetika shqiptare*, Tiranë, 2010, f. 435.

⁴ E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936, f. 57.

më 1880), traduktorin e math të Shakespeare-it dhe Omar Khajam-it (Kheyyam) në gjuhën nënore, autorin e monografisë më të mirë që ekziston mi jetën dhe vepërimin e Gjergj Kastriotit, “*Historia e Skënderbeut*”, Boston 1921 shkrojtur me një kriter të lëvduarshëm”.⁵ Këto rreshta për F. S. Nolin Poradeci i ka shënuar më 23 janar 1937, rreth 5 muaj para se të dorëzonte për botim “*Anthologjinë ...*”. Ky është një provokim për ne dhe hipotezat që mund të lidhen me arsyen përse Noli nuk është përfshirë në veprën antologjike të tij.

Faik Konica

Për personalitetin letrar e kritik që ai përfaqësonte në vitin 1936, Çabej vlerëson: *Në shkrimet e tij të paka Faiku përdor një stil të mprehtë dhe shumë herë të ashpër. Shqipja e tij e thjeshtë dhe e kulluar u bë model për shumë shkrimtarë të tjerë. Le të shpresojmë që autori t’i fali literaturës shqipe dhe vepra të tjera nga të cilat disa kanë qenë paralajmëruar ...*⁶.

Si personalitet kritik Konica ishte shfaqur që në 1897 kur boton të përkohshmen “*Albania*” deri në 1909. Në rubrikën “*Kohëtore e letrave shqipe*” u hodhën bazat e kritikës letrare dhe Konica u konsiderua me të drejtë si themeluesi teorik dhe praktik i kritikës letrare shqipe. “*Doktor gjilpëra ...*” ishte botuar që në vitin 1924 kishte botime si: “*Trumbeta e Krujës*” (më vonë “*Ushtrimi i Krujës*”), ishte udhëheqësi i Federatës “*Vatra*” dhe redaktor i fletores “*Dielli*”. Në vitin 1937, ai vazhdonte të ishte ministër fuqiplotë i Mbretërisë Shqiptare në Washington.

Të gjitha këto për F. Konicën, Dr. Llazar Gushe nuk kishte si të mos i dinte e madje t’i njihte mirë. Pikërisht, tingëllon çuditshëm që ai kalon shkarazi mbi Konicën në “*Shënime rreth literaturës shqipe*”⁷ duke u shprehur për të thjesht si një polemist i mprehtë dhe shqipëronjës i një trumbe nga “*1001 net*”.

Nëse Nolin e lehtëson justifikimi si një kundërshtar i hapur i Mbretërisë dhe personalisht mbretit Zog, që Poradeci të mos e përfshinte në antologji, Faik Konica mbetet jashtë këtij justifikimi.

Dihet që në momentin e përfundimit të dorëshkrimit nga Ll. Gushe, ai është ministër i Mbretërisë së Zogut (edhe pse njihen hapur polemikat e

⁵ L. Poradeci, *Vepra II* (Publicistikë, Kritikë letrare, ...), Tiranë, 2010, f. 339.

⁶ E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936, f. 56.

⁷ L. Poradeci, *Vepra II*, (Publicistikë, Kritikë letrare, Anthologji shqipe e kësikohëshme), Tiranë, f. 339.

ashpra në marrëdhëniet mes Konicës dhe mbretit Zog). Por, një antologji e ndërtuar në mënyrë profesionale nuk do ta përfillte as justifikimin për Nolin. Për këtë arsye mbetet të pranojmë përmes një gjykimi të ftohtë që Ll. Gusho nuk i ka shpëtuar dot diktimit të politikave zyrtare të kohës në fjalë. ... *Noli ishte kundërshtar i Mbretërisë. Zgjedhja e Poradecit ishte njëherësh edhe konform politikës zyrtare (të kohës), por njëherazi edhe identifikim i shijes vetjake të tij. Ndërsa rasti i Konicës del në formën e një pikëpyetjeje.*⁸ Që kritika impresioniste e Konicës kërkon për letërsinë përjashtimin e elementeve jashtëletrare qoftë edhe nacionale, që kërkon një letërsi të pastër e që do ta shqyrtojë veç poetin nga atdhetari, këto janë elemente të një pjekurie moderne, të cilat vetë Ll. Gusho i ka përqafuar.

Atëherë: Përse nuk e zgjedh Konicën? Përveç arsyeve të tjera që mbeten për t'u parë e shqyrtuar, kjo rezulton të jetë një tekë e Poradecit, që çuditërisht nuk përkon me shijen estetike të Lasgushit.

Migjeni

Në vitin 1937, Migjeni prezantohej në një tjetër sfond. Kushtet politike dhe masat që merrte regjimi i Zogut për t'u mbrojtur nga kundërshtarët e tij prisnin me dy tehe: edhe ata që i dëlnin hapur përballë politikisht si p.sh. Fan Noli, edhe ata të tjerët, të nëndheshmit që rebelohen në artin e tyre ndaj çdo lloj prange deri në blasfemi (edhe kundër vetë Zotit) si Migjeni.

Në vitin 1937, kur po përgatitej antologjia, Migjeni sapo kishte botuar "*Vargjet e lira*" (1936), të cilat u ndaluan menjëherë pas daljes nga shtypi. Ndërsa në një antologji⁹ të shtypshkronjës "*Gutenberg*" (1939) Migjeni del i prezantuar përmes tri poezive: "*Kangët e pakëndueme*", "*Kanga e të burgosunit*", "*Baladë qytetse*". Gjithsesi, Migjeni nuk qe i panjohur për periodikët e kohës ("*Illyria*", "*Bota e re*" etj.). Përsëri del varësia nga politikat zyrtare, të nxjerrë kokën dhe të shënojë edhe mungesën e Migjenit.

"*Vargjet e lira*" nuk qenë të lira të merreshin nga shqiptarët, por kjo u korrigjua në vitin 1944, kur së bashku me "*Këngët e fundit*" të vitit 1937, u bë një botim i "*Vargjeve të lira*". "*Mungesa e Migjenit duhet të shpjegohet jo vetëm me kohën kur u përgatit antologjia, 1937, por edhe me fatin që "Vargjet e lira" u hoqën nga qarkullimi menjëherë pas botimit dhe*

⁸ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Studime, Tiranë, 2010, f. 62.

⁹ *Anthologji, Poetve të vdekur* (Pa autor), Botim I Shtypshkronjës "*Gutenberg*", Tiranë, Tetor 1939. Gjetet ne Bibliotekën Kombëtare: S 11 D 111.

*u desh mjaft kohë për t’u përhapur e për t’u bërë të njohura.”*¹⁰ Në nr. 51 të datës 11 prill 1936 e përkohshmja “Illyria”, ku u botuan një pjesë e madhe e prozave të Migjenit lajmëronte botimin e afërm të “Vargjeve të lira”. “... disa muaj me vonë libri ishte gati, i mungonte vetëm indeksi. Kur befasi, Migjeni e pezulloi botimin, dhe libri i paplotsuem, shtypun në njimij copë, mbeti atëherë e deri sot ndër depot e shtypshkronjës “Gutenberg”. Kështu shkruan Arshi Pipa në revistën e përmuajshme “Kritika”, Nr. 3 të muajit maj ’44.

Pyetjes se përse nuk janë përfshirë Noli, Konica e Migjeni, po të mos ishim kaq larg në kohë, në skaj të viti 2017, nuk do ta shtronim me kaq forcë e ndoshta edhe ashpërsi. Kur vështron nga e tashmja të shkuarën ke luksin të kesh në pëllëmbë të dorës panoramën e startit, kulmimit, mbylljes dhe jehonës së veprës së një shkrimtari.

Llazar Gushe punoi në një moment të vështirë kohor, në momentin kur kushtet politiko-sociale nuk favorizonin. Llazar Gushe ndërtoi një antologji bazuar në kriteret përkatëse, mirëfilli estetike. Por nuk mund të pohojmë me të njëjtën forcë për pavarësinë e tij të plotë nga politikat zyrtare dhe nga diktati i kohës në të cilën ai e shkroi antologjinë e tij mbi letërsinë moderne shqipe. Letërsia moderne që një rritje dhe arritje për letrat shqipe e po e tillë mbetet edhe *Anthologjia shqipe e kësikohëshme* e Llazar Gushos.

Fjalët kyçe: antologji, rilexim, kriteret estetike, kontekst, filtra, kritik.

¹⁰ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Studime, Tiranë, 2010, f. 62.

